



## Shendet i jauj, siguria juaj: Udhëzues për punëtoret

Your health, your safety: A guide for workers

Ky informacion jepet nga Health and Safety Executive (HSE) (Ekzekutivi i Shëndetit dhe Sigurisë) në bashkëpunim me Trade Union Congress (TUC) (Kongresi i Sindikatave). HSE është një organizatë qeveritare që punon përmes mbrojtjen e shëndetit, sigurisë dhe mirëqënieve së punëtorëve duke zbatuar ligjet e shëndetit dhe sigurisë dhe duke ofruar këshillë dhe përkrahje. TUC përfaqëson mbi 70 sindikata me më tepër se 6.5 milion anëtarë. Kjo organizatë lufton përmes drejtësisë dhe kushte të mira pune.

Në qoftë se jeni punëtor (me kohë të pjesëshme ose të plotë, i përkohshëm ose i përhershëm), ky informacion shpjegon se cilat janë të drejtat tuaja, çfarë duhet të shpresoni nga punëdhënësi, çfarë përgjegjësish keni dhe ku të shkonit përmes ndihmës. Kjo gjithashtu ka vlerë dhe për ju, në qoftë se jeni një person i ri që punoni përmes fituar eksperiencë, jeni çirak, punëtor bamirësie, punëtor i lëvizshëm ose punoni nga shtëpia.

Në qoftë se jeni punëtor i përkohshëm, i punëve të rastësishme ose punëtor agjensie, agjensia/buznesi që ju puneson, punëdhënësi, kontraktori ose personi që ju ka marrë në punë ka një detyrë ligjore përmes t'ju garantuar juve të drejtat e mëposhtme:

### Ju keni të drejtën:

- Të punoni në vende ku të gjitha rreziqet ndaj shëndetit dhe sigurisë tuaj janë kontrolluara plotësisht.
- Të ndërprisni punën dhe të largoheni nga zona ku punoni në qoftë se mendoni se jeni në rrezik.
- Të informoni punëdhënësin përmes problemeve dhe shqetësimëve që kanë të bëjnë me shëndetin dhe sigurinë tuaj.
- Të kontaktoni HSE ose Autoritetin tuaj lokal në qoftë se keni ende shqetësimë që kanë të bëjnë me shëndetin dhe sigurinë tuaj dhe të mos futeni në telashe.
- Të bëheni anëtar i sindikatës dhe të jeni përfaqësues i sigurisë.
- Të paguheni përmes kohën që trajnoheni, në qoftë se jeni përfaqësues i sigurisë
- E pushimit të paktën përmes 20 minuta në qoftë se punoni më shumë se 6 orë dhe të drejtën e pushimeve vjetore të paguara.

### Ju duhet:

- Të kujdeseni përmes shëndetit dhe sigurinë tuaj dhe të personave të tjera që mund të ndikohen nga ajo që ju bëni (ose nuk bëni)
- Të kooperoni me të tjera në lidhje me çështjet e shëndetit dhe sigurisë dhe të mos dëmtoni, keqpërdorni ndonjë gjë që ofrohet përmes shëndetit, sigurinë ose mirëqënieve tuaj.

### **Punëdhënësi duhet t'ju thotë:**

- Për rreziqet që i kanosen shëndetit dhe sigurisë tuaj nga proçese pune të tanishme ose të ardhshme.
- Për gjëra ose ndryshime që mund të dëmtojnë ose ndikojnë tek shëndeti dhe siguria jauj
- Si ta kryeni punën në mënyrë të sigurtë
- Çfarë është bërë për mbrojtjen e shëndetit dhe sigurisë tuaj
- Si të merrni ndihmën së shpejtë.
- Çfarë të bëni në rast emergjencë

### **Punëdhënësi duhet t'ju ofrojë falas:**

- Trajnim që ta kryni punën duke qenë të sigurtë.
- Mbrojtje për ju në punë, kur është e nevojshme (sic janë rroba, këpucë ose çizme, mbrojtje për veshët dhe sytë, dorashka, maska etj)
- Kontrolle mjekësor(shëndetësore) në qoftë se ka rrezik sëmundje për shkak të punës.
- Kontrolle të rregullta mjekësore në qoftë se punoni natën dhe një kontroll përpara se të filloni.

(Shënim: Në qoftë se jeni me të vërtëtë i vetëpunësuar ju mbani vetë përgjegjësi për ndihmën e shpejtë, trajnimin, paisjet mbrojtëse dhe kontrolllet mjekësore dhe për organizimin e orarit tuaj të punës)

### **Punëdhënësi duhet t'ju japë informacionin e mëposhtëm:**

- *Ligjin e shëndetit dhe sigurisë: Çfarë duhet të dini.* Kjo do t'ju japë adresën ku mund të kontaktoni përsonat që mund t'ju ndihmojnë.
- Një deklaratë mbi qëndrimin e tyre ndaj shëndetit dhe sigurisë.
- Një Çertifikatë bashkëkohore Siguracioni e Punëdhënësit duhet të vendoset në një vend të dukshëm në vendin tuaj të punës.

### **Çfarë duhet të bëni në se jeni të shqetësuar për shëndetin dhe sigurinë tuaj:**

- Telefononi Linjën e Informacionit të HSE 08701 545500 për t'u këshilluar ose ankuar ose linjën e Njohjes me të Drejtat Tuaja të TUC 08701 600 4882.
- Në qoftë se donit të bisedonit me dike në një gjuhë më të përshtatshme për ju, ju lutem telefononi 08701 545500 dhe i thoni operatorit çfarë gjuhe.
- Në qoftë se keni humbur punën për shkak të një çështje të shëndetit dhe sigurisë ju mund të jeni në gjendje të ankoheni tek Tribunali i çështjeve të Punësimit. Pyesni sindikatën tuaj ose Byronë lokale të Këshillimit të Qytetarëve (Citizens Advice Bureau) për këshillë.